



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Thirrje për mobilitet të studentëve të UKZ-së në Universitetin e PH Zug në Zvicër

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes UKZ dhe PH Zug për mobilitetin e studentëve, do të bëhet përzgjedhja e studentëve për vizitën studimore në Universitetin PH ZUG në Zvicër, e cila u mundëson 15-të studentëve nga Universiteti Publik "Kadri Zeka" të jenë pjesë e këtij shkëmbimi.

Mobilitetet ndihmojnë studentët e UKZ-së të ngriten profesionalisht dhe të përfitojnë nga eksperiencat e ndryshme që ata marrin nga vizitat e shumë vendeve dhe Universiteteve Ndërkombëtare, prandaj aplikoni për të pasur një eksperiencë në Universitetin e PH Zug në Zvicër.

Mobiliteti i studentëve të UKZ-së në PH Zug Zvicër do të realizohet në muajin dhjetor 2025, paraprakisht studentët e përzgjedhur të UKZ-së do të presin studentët nga PH Zug në muajin tetor 2025, ku përgjatë një (1) jave do të ketë aktivitete të ndryshme.

Përzgjedhja e studentëve do të bëhet duke ju përmbajtur kriterëve të mëposhtme:

1. Gjithsej 15 studentë do të jenë pjesë e programit për vitin 2025;
2. Mobiliteti zgjat një (1) javë;
3. Gjithsej do të pranohen 15 studentë, të gjithë nga Fakulteti i EDUKIMIT;
4. Nëse nuk do të mbushet numri nga studentët e Fakultetit të EDUKIMIT atëherë do të pranohen edhe studentë nga fakultetet e tjera.
5. Nga intervista do të caktohet një student lider i grupit që do të jetë përgjegjës për grupin gjatë gjithë vizitës studentore;
6. Studentët duhet të flasin gjuhën angleze, përparësi llogaritet edhe gjuha gjermane (do të testohen për gjuhë në ZMJ);
7. Studentët duhet të kenë aftësi të mira komunikimi, të jenë të përkushtuar ndaj programit, të punojnë në mënyrë efektive në grupe, të bashkëpunojnë paraprakisht me studentët e PH Zug dhe të përshtaten me kërkesat e ZMJ për realizimin me sukses të programit;
8. Të jetë i/e gatshme të mirëpresë në shtëpi një studentë nga PH Zug për një javë;
9. Të prezantoj ndonjë ide të rëndësishme për diskutim gjatë procesit të intervistës, me të cilën do të merret gjatë udhëtimit në PH Zug të Zvicrës;
10. Të marrë pjesë në të gjitha grupet punuese në UKZ, gjatë vizitës së studentëve nga PH Zug;



Të gjithë studentët e interesuar, duhet të lajmërohen tek Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e UKZ-së, deri me datën **26/09/2025**, nga ora **09:00-16:00 CET** dhe duhet të kenë me vete:

- o Vërtetimin që janë studentë;**
- o Certifikatën e notave dhe**
- o Kopjen e pasaportës me vlefshmëri minimale të afatit deri me 31/12/2025.**

Suksese të gjithë studentëve.

Prof. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte

